



Data: 06.07.2017

Ref.: 580/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 51-të, të mbajtur më 23 Qershor 2017, mori:

V E N D I M

- I. Pezullohet akreditimi i programeve të studimit të BPrAL Kolegji “Biznesi” kampusi në Prishtinë për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2018:
 - Menaxhment dhe Ekonomiks, BA, 180 ECTS, (vendimi nr. 550/14, datë 04/07/2014);
 - Menaxhment dhe Financa, MA, 120 ECTS, (vendimi nr. 550/14, datë 04/07/2014);
 - Menaxhimi i Emergjencave, BA, 180 ECTS, (vendimi nr. 645/16, datë 15/07/2016);
 - Menaxhimi i Emergjencave, MA, 120 ECTS, (vendimi nr. 550/14, datë 04/07/2014);
 - Banka dhe Financa në Biznes, BA, 180 ECTS, (vendimi nr. 645/16, datë 15/07/2016);
 - Juridik – Penal, LLM, 60 ECTS, BA, 180 ECTS, (vendimi nr. 645/16, datë 15/07/2016).

- II. Pezullohet akreditimi i programeve të studimit të BPrAL Kolegji “Biznesi” dega në Prizren për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2018:
 - Banka dhe Financa në Biznes, BA, 180 ECTS, (vendimi nr. 645/16, datë 15/07/2016);
 - Menaxhimi i Emergjencave, BA, 180 ECTS, (vendimi nr. 645/16, datë 15/07/2016).

- III. Pezullohet akreditimi i programit të studimit të BPrAL Kolegji “Biznesi” dega në Vushtrri për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2018:
 - Menaxhment dhe Ekonomiks, BA, 180 ECTS, (vendimi nr. 550/14, datë 04/07/2014);
 - Juridik, LLB, 240 ECTS, (vendimi nr. 550/14, datë 04/07/2014);
 - Banka dhe Financa në Biznes, BA, 180 ECTS, (vendimi nr. 645/16, datë 15/07/2016);
 - Menaxhimi i Emergjencave, BA, 180 ECTS, (vendimi nr. 645/16, datë 15/07/2016).

- IV. Pezullohet akreditimi i programit të studimit të BPrAL Kolegji "Biznesi" dega në Gjakovë për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2018:
- Menaxhimi i Emergjencave, BA, 180 ECTS, (vendimi nr. 645/16, datë 15/07/2016);
 - Banka dhe Financa në Biznes, BA, 180 ECTS, (vendimi nr. 645/16, datë 15/07/2016).
- V. Ndalohej regjistrimi i studentëve në vitin akademik 2017/2018 në programet e studimit të cekura në pikën I, II, III, dhe IV të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Bazuar në kërkesën e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) drejtuar të gjitha Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) për dorëzimin e listave të stafit akademik për të gjitha programet ekzistuese, dhe pas verifikimit nga AKA të dokumentacionit të dorëzuar nga BPrAL Kolegji "Biznesi", u konstatua se programet e cekura në pikat I, II, III dhe IV të këtij vendimi nuk i plotësojnë kriteret sipas Udhëzimit Administrativ (nr.20/2016, datë 20.09.2016) mbi Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (UA për Akreditim). Sipas nenit 11, pika 3.2 e UA për Akreditim për secilin program të studimit duhet të kenë të paktën tri staf akademik me marrëdhënie të rregullt të punës me gradën shkencore Dr.sc.

Bazuar në kriteret të cilat i parashihen në UA për Akreditim, nenit 11, pika 3.2 dhe 3.3 e UA, janë trajtuar të gjitha dokumentet të cilat janë dorëzuar nga Kolegji "Biznesi", dhe si përfundim është konstatuar që asnjëri nga programet e cekura në pikat I, II, III dhe IV, të këtij vendimi nuk posedojnë nga tre Dr.sc. me dokumentacion të rregullt sipas kërkesave të AKA-së.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2017 ka shqyrtuar të gjitha dokumentet e dorëzuara nga BPrAL Kolegji "Biznesi", dhe ka konstatuar që programet e cekura në pikën I, II, III dhe IV të këtij vendimi nuk i përmbushin kriteret e cekura në UA për Akreditim, dhe në këtë rast KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bazuar në UA për Akreditim, neni 28, pika 2 dhe 3, AKA mund ta tërheq akreditimin në rastet e caktuara. Sipas këtij neni, AKA mund ta tërheq akreditimin në rast se ka dëshmi se cilësia e ofrimit të programeve të studimit në një ose më shumë fusha për të cilat është dhënë akreditimi është dëmtuar në masë të madhe në këtë rast KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet në Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Kjo këshill juridike jepet duke u bazuar nenin 157 (Dispozitat kalimtare) të Ligjin për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr.05/L-031, datë 25 maj 2016) i cili ka hyrë në fuqi me 21 qershor 2017. Sipas këtij neni Procedurat administrative të filluara dhe të pa përfunduara në datën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji, do të vazhdojnë sipas dispozitave të mëparshme ligjore, që kanë rregulluar procedurën administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "Biznesi";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

